



INFRASTRUKTURA E MBROJTJES NGA PËRMBYTJET NË LUMIN MAT, PËRGATITJA E PROJEKTIT TË ZBATIMIT, VLERËSIMIT I STRATEGJIK I NDIKIMIT MJEDISOR, PROJEKTIM I ZBATIMIT DHE PËRGATITJA E DOKUMENTAVE TË TENDERIT



SHTRIRJA E PROJEKTIT
BASENI UJOR MAT




FINANÇIMI
GRANT: EUR 450,000



DONATORI:
WBIF



PËRFITUES
**MBZHR
AMBU**



KOHËZGJATJA E PROJEKTIT
Janar 2020- Prill 2021



REALIZIMI
100 %



REZULTATET E PROJEKTIT

Projekti do të kontribuojë në arritjen e rezultateve të mëposhtme:

1. Reduktimi i rrezikut nga përmbytjet për 210000 njerëz që jetojnë në zonën e pellgut ujëmbledhës;
2. Zvogëlimi i kërcenimit për humbjet e jetës njerëzore dhe pasurisë;
3. Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm të bujqësisë dhe vendbanime pa rrezik përmbytjeje;
4. Rritja e mundësive për punësim;
5. Reduktimi i erozionit të tokës dhe bregut të lumit;
6. Zvogëlimi i humbjeve financiare dhe ekonomike nga përmbytjet.

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Lumi Mat, duke qënë një nga lumenjtë më të mëdhenj në vend, karakterizohet nga tipare që janë karakteristike për të gjithë vendin: zona e pellgut ujëmbledhës është relativisht e madhe (2 441 km²) dhe malore, me fushat aluviale në rrjedhën e poshtme, ku një pjesë e madhe e popullsisë dhe ekonomia e vendit janë të ekspozuar ndaj efekteve negative të përmbytjeve për shkak të reshjeve të shiut, shkrirjes së bores së akumuluar dhe efektit indirekt të lëvizjeve të nivelit të detit (baticë, meteorologjike dhe klimatike).

Realizimi i këtij projekti do të përmirësojë situatën e përmbytjeve dhe do të sigurojë mbrojtjen e zonave në rrjedhën e poshtme të lumit Mat me një gjatësi të përafërt prej 13 kilometrash. Rritja e nivelit të mbrojtjes nga përmbytjet dhe parandalimi i dëmtimeve të shëndetit të njerëzve, florës dhe faunës do të kontribuojnë për të siguruar funksionimin e qëndrueshëm të bujqësisë, turizmit dhe aktiviteteve të tjera ekonomike në zonën e pellgut ujëmbledhës.

PUBLIKIME

<http://www.ambu.gov.al/perfundimi-i-asistences-teknike-te-financuar-nga-be-per-infrastrukturen-e-mbrojtjes-nga-permbytjet-ne-shqiperi/>